



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/05-126454/25, me 21 AUG 2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010 dhe Rregullores (QRK) nr.01/2025 për Mekanizimin Koordinues Lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Caktohet Mekanizmi Koordinues Lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, Mekanizmi ka këtë përbërje:
 1. Kryetari i Komunës – Kryesues;
 2. Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale apo Drejtori përkatës që mbulon fushën e Shëndetësisë apo Mirëqenies Sociale;
 3. Drejtori i Qendrës për Punë Sociale;
 4. Udhëheqësi i Shërbimeve Sociale, Qendra për Punë Sociale;
 5. Drejtori Komunal i Arsimit;
 6. Zyrtari për Barazi Gjinore;
 7. Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
 8. Përfaqësues nga Zyra për Komunitete dhe Kthim;
 9. Përfaqësues nga Strehimorja;
 10. Përfaqësues nga OJQ-të në nivelin lokal, aktive në të drejtat e njeriut/ grave.
3. Përveç anëtarëve të cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, ftohen të marrin pjesë në Mekanizëm edhe:
 1. Mbrojtësi i viktimave nga Zyra për Mbrojtje dhe ndihmë viktimave;
 2. Përfaqësues nga Gjykata;
 3. Përfaqësues nga Prokuroria;
 4. Përfaqësues nga Policia;
 5. Përfaqësues nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas;
 6. Përfaqësues nga Zyrat e Punësimit;
 7. Përfaqësues nga Qendrat e Shëndetit Mendor.



4. Në mungesë të Kryesuesit, rolin e Zëvendëskryesuesit të Mekanizmit Koordinues Lokal e ushtron Nënkryetari i Parë i Komunës.
5. Detyrat dhe punët e Mekanizmit të cekur në pikën 2 dhe 3 të këtij Vendimi, janë të përshkruara në nenin 5 të Rregullores (QRK) nr.01/2025 për Mekanizimin Koordinues Lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore.
6. Takimet e rregullta të Mekanizmit Koordinues Lokal mbahen çdo tre (3) muaj.
7. Kryesuesi i Mekanizmit përkatës paraqet raport të punës së paku një (1) herë në vit në Kuvendin Komunal të Komunës.
8. Kryesuesi i Mekanizmit paraqet raport të punës çdo gjashtë (6) muaj pranë Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtje nga dhuna në familje për zbatimin e planeve komunale të veprimit në përputhje me Strategjinë Kombëtare kundër dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore dhe Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
9. Për mbështetje administrative teknike, Sekretari e Mekanizmit caktohet Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
10. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarisë janë të përcaktuara në nenin 8, paragrafi 4, të Rregullores.
11. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të Mekanizmit;
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

